

**PROGRAMI I PUNËS**  
**MBI GJETJET NGA AUDITIMI I KONTROLLIT TË LARTE TË SHITIT PËR PERIUDHËN JANAR-TETOR 2019**  
 (Në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Rekomandimet)

Nr.	Gjetja nga auditimi	Rekomandimi	Struktura përgjegjëse	Rëndësia	Afati	Shënime mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimit
<b>B. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI</b>						
1	Shërbimi i përkthimit zyrtar, nuk është i klasifikuar si profesion i rregulluar dhe nuk përfshihet në profesionet e parashikuara në ligjin nr.10171, datë 22.10.2009, "Për Profesionet e Rregulluara në Republikën e Shqipërisë", apo në profesionet e përcaktuara me ligje të veçanta, duke krijuar problematikë në aspektin e ndarjes të drejtë të punës, për përkthyesit e jashtëm të kontraktuar.	1.1 Ministria e Drejtësisë, të ndërmarrë nismat e nevojshme administrative e ligjore për plotësimin e kuadrit ligjor për "Përkthyesin zyrtar", për të garantuar profesionistë mbi bazën e meritokracisë, shërbime përkthimi sa më cilësore dhe një veprimtari të rregulluar nga akte ligjore të mirëpërcaktuara.	Drejtoria për Marrëdhëniet Juridiksionale dhe Bashkëpunimin Ndërgjyqësor	E lartë	Brenda datës 29.02.2020	Ministria e Drejtësisë në kuadrin e planit legjislativ të miratuar me VKM-në nr. 837, datë 24.12.2019, "Për miratimin e programit të përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2020", ka parashikuar hartimin e projektligjit, "Për përkthimin zyrtar".
		1.2 Ministria e Drejtësisë, të plotësojë gjithashtu bazën ligjore mbi procedurat e përzgjedhjes dhe kontraktimit të përkthyesve të jashtëm, duke u orientuar drejt trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues të operatorëve ekonomikë, si dhe duke treguar vëmendje të veçantë në reduktimin e riskut të mundshëm për rrjedhjen e informacionit të klasifikuar gjatë procesit të përkthimit.	Drejtoria për Marrëdhëniet Juridiksionale dhe Bashkëpunimin Ndërgjyqësor		Brenda datës 29.02.2020	Në bashkëpunim me DSIK do sugjerohet shtimi i rregullave specifike në lidhje me komunikimin me përkthyesit të cilët administrojnë dokumentacion të klasifikuar sekret, duke parashikuar detajet procedurale të komunikimit me këta përkthyes.
<b>C. MASA ORGANIZATIVE</b>						
1	a. Funksionimi i Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm me organikë të pa plotësuar, duke sjellë problematika në realizimin e planit vjetor të auditimit.	1.1 Nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, të merren masa, për plotësimin e vendeve vakantë në strukturën e miratuar në nivel specialisti dhe Drejtuesi si dhe të ndërmerrin hapat e nevojshëm administrativë dhe ligjorë për zgjerimin e kësaj strukture, me qëllim garantimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe evidentimin e rasteve të keqpërdorimit të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike.	Drejtoria e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve	E lartë	Menjëherë	Me shkresën e Departamentit të Administratës Publike me Nr.4960, datë 23.08.2019, është zbatuar procedura e emërimit (nëpunës civil në periudhë prove), për specialist në Drejtorinë e Auditimit në Ministrinë e Drejtësisë. Pozicionet e pa plotësuara, janë në proces rishpallje.
	b. Në planin vjetor të auditimeve, rezultojnë devijime dhe mospërputhje me Planin Strategjik 2018-2020, për të cilat nuk ka shpjegime dhe nuk janë miratuar nga Komiteti i Auditimit.	1.2 Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të rishikoj planin vjetor për vitin 2020 duke përfshirë në të edhe subjektet të cilat nuk janë audituar prej saj gjatë vitit 2019. Plani i rishikuar, pas mendimit të Komitetit të Auditimit dhe miratimit nga Titullari i Institucionit, të paraqitet rregullisht pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit në MFE me shpjegimet përkatëse.	Drejtoria e Auditimit të Brendshëm		Në vijimësi	Në përgatitjen e planit vjetor për vitin 2020, NjAB ka mbajtur parasysh dhe është bazuar më shumë mbi informacionet e vlerësimit të riskut. Programimi i aktiviteteve për planin vjetor është realizuar në përputhje me burimet njerëzore dhe materialet në dispozicion të NjAB-së. Manuali i AB/2016. Nga ana e DAB të Ministrisë së Drejtësisë me shkresën nr 6668/1 dt 17/10/2019 "Mbi miratimin e planit Strategjik 2020-2022 si dhe planit vjetor 2020" i është përcjelle Ministrisë së Financave Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit dhe Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik. Ky plan është miratuar me vendimin nr.2 dt 10.10.2019 të Komitetit të auditimit, brenda afateve ligjore që parashikon Manuali i Auditimit si dhe në zbatim të gërmës c, të nenit 14, të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik". Gjithashtu theksojmë se kanë kaluar të gjitha afatet për ndryshimin e planit, kjo si pasojë dhe e mungesës së Drejtorit të kësaj drejtorie, por nga ana e DAB të MD do pa
	c. Mospërfshirje në planin e auditimeve të vitit 2020, i auditimeve të parrealizuara gjatë vitit 2019, gjë e cila sjell shkëputje të vijueshmërisë dhe ul besueshmërinë, për hartimin e një plani të bazuar në vlerësim objektiv të riskut, për vitin në vijim.	1.3 Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të programoj auditime të plota, brenda afateve të arsyeshme, dhe të shtrirë në gjithë periudhën vjetore, duke respektuar rigorozisht periudhën e njoftimit si dhe të gjitha hapat e	Drejtoria e Auditimit të Brendshëm		Në vijimësi	NjAB ka marrë menjëherë masat për plotësimin e të gjithë hapave gjatë angazhimeve të auditit, në përputhje me Manualin e AB/2016. Konkretisht, në angazhimin e iniciuar për auditimin, grupi i audituesve ka realizuar njoftimin 10 ditë pune përpara takimit fillestar, duke

	d. Mosrespektim i afatit 10 ditor të njoftimit të njësisë që do të auditohet, si dhe pamjaftueshmëri në formimin profesional, për auditimin e Teknologjisë dhe Informacionit.	gere të natimit, miratimit dhe dërgimit të raporteve përkatës drejt subjektit të audituar, duke mos krijuar tejkalime afatesh procedural të cilët krijojnë risk të lartë në veprimtarinë e kësaj njësie.	Drejtuesit			dakordësuar në këtë pikë me gjetjen me vend të grupit të audituesve nga KLSH-ja, evidentuar nga auditimet e mëparshme, si dhe ndjekjen e të gjithë hapave të tjerë.
2	Mosderdhje në buxhetin e shtetit dhe në afatin ligjor, i të ardhurave të krijuara gjatë vitit 2017 dhe 10 muajorit 2018, nga Drejtoria e Përbarimit Tiranë, në shumën <b>45,431,414 lekë</b> , në shkelje të ligjit nr.9975, datë 28.07.2008 "Për Taksat Kombëtare".	<b>2.1</b> Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të dërgoj një kopje të raportit të Auditimit të mbajtur pranë Drejtorisë së Përbarimit Tiranë në Drejtorinë e Përgjithshme të Përbarimit dhe të kërkoj, ndjekjen nga ana e saj të problematikës së degëve nëpërmjet nxjerrjes së shkresave njoftuese/qarkoreve lidhur me "Llogarinë Përbarimore", me theks të vecantë derdhjen në buxhet të të ardhurave përbarimore (tarifë/gjobë/interesa) si dhe sistemin e zërit "Të tjera" në këtë llogari.	Drejtoria e Auditimit të Brendshëm	E lartë	Brenda datës 31.01.2020	Nga ana e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, në Ministrinë e Drejtësisë, është dërguar raporti përfundimtar i auditimit në institucionin e audituar konkretisht në DPP, me shkresën nr.5677/8, datë 17.02.2020.
3	Moskordinim i procedurës së caktimit nga Ministria e Drejtësisë dhe miratimit nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë të Nëpunësit Autorizues në Institutin e Mjekësisë Ligjore.	<b>3.1</b> Nga Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të merren masa për emërimin dhe realizimin e ndryshimit të Nëpunësit Autorizues të Përkohshëm, referuar shkresës së IML me nr.1616 prot, datë 21.09.2018 dhe nr.1855 prot datë 09.03.2019, me të cilat është kërkuar ndryshimi respektiv, për caktimin e titullarit të institucionit z.Bledar Xhemali në pozicionin e nëpunësit autorizues.	Drejtorja e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve	E lartë	Menjëherë	Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me DAP punon për gjetjen e zgjidhjeve për ndryshimin e Nëpunësit Autorizues të Përkohshëm.
4	Mospërfundim të midis vlerës totale të fondit bruto të pagave dhe listëpagesave mujore të deklaruar në Degën e Tatimeve, në shumën <b>469,192 lekë</b> , për periudhën Janar-Shtator 2019, si dhe moskordinim të shumës së pagave neto të punonjësve sipas librit të pagave dhe pagësës neto dhe detyrimeve të deklaruar në Drejtorinë e Tatimeve, në shumën <b>469,192 lekë</b> .	<b>4.1</b> Ministria e Drejtësisë, të marrin masat e nevojshme për kontabilizimin e saktë të pagave dhe kontributeve në sistemin informatik për periudhën Janar-Shtator 2019 dhe kuadrinim e vlerave midis librit të pagave dhe listëpagesave mujore.	Drejtorja e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar (Sektori i Financës)	E lartë	Menjëherë dhe në vijimësi	Në lidhje me këtë rekomandim nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, janë kryer menjëherë korigjimet e duhura dhe janë derdhur në Drejtorinë e Tatimeve detyrimet, me USH nr.10, dt 13.01.2020 listëpagesa Shkurt 2019, USH nr.11, dt 13.01.2020 listëpagesa Mars 2019, USH nr.12, dt 13.01.2020, listëpagesa Prill 2019, USH nr.13, dt 13.01.2020 listëpagesa Maj 2019, USH nr.14, dt 13.01.2020 listëpagesa Qershor 2019, USH nr.15, dt 13.01.2020 listëpagesa Korrik 2019, USH nr.16, dt 13.01.2020 listëpagesa Gusht 2019, USH nr.17, dt 13.01.2020 listëpagesa Tetor 2019, USH nr.18, dt 13.01.2020 listëpagesa Janar 2019.

te fotokopjohet

**D. MASA PER ELEMIMININ E EFEKTEVE NEGATIVE TE KONSTATUARA NE ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PER MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE**

1	a. Evidentohet se, institucioni nuk disponon një mekanizëm të plotë dhe transparent për shpërndarjen e materialeve të përkthimit drejt përkthyesve të njohur prej saj duke bërë që një numër i kufizuar përkthyesish të kryejnë shërbimin në favor të kësaj ministrie por edhe prej tyre të ketë diferencë domethënëse në vlerat e përfuturave, çka në situatën e një çmimi fikse të rregulluar "përkthehet" në më shumë punë e marrë. Kjo mënyrë ka krijuar pabarazi në këtë kategori profesioni ende "të parregulluar".	<b>1.1</b> Nga Ministria e Drejtësisë, të merren masat e nevojshme për ndërprerjen e shërbimeve të marra nga përkthyes të përgjithshëm në organet fiskale, kjo në zbatim të dispozitave ligjore që rregullojnë, funksionimin e sistemit buxhetor, taksat dhe tatimet, si dhe për të shmangur diskriminimin e operatorëve ekonomike kundrejt konkurrencës së pandershme.	Drejtorja për Marrëdhëniet Juridiksionale dhe Bashkëpunimin Ndërgjyqësor	E lartë	Menjëherë	Ministria e Drejtësisë, me qëllim rregullimin e procesit në zbatim të rekomandimeve të KLSH-së, ka parashikuar këto parime në draft Urdhërin e Ministrit (në proces) duke specifikuar kriteret e përzgjedhjes që lidhen me cilësinë, gatishmërinë dhe korrektësinë të përkthyesve të autorizuar.	
	b. Janë kontraktuar përkthyes të përgjithshëm në organet fiskale, duke krijuar trajtim të pabarabartë, diskriminues dhe standard të paprshatshëm institucional dhe mënyra e pagesës së tyre, bie B31ë kundërshtim me Ligjin nr.9920 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.					Drejtorja për Marrëdhëniet Juridiksionale dhe Bashkëpunimin Ndërgjyqësor & Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar	Në lidhje me këtë rekomandim të KLSH-së, nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, janë marrë masat që për vitin 2020 të kontraktohen vetëm përkthyes të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
	c. Mungesa e një sistemi rregullator, në lidhje me marrjen dhe dorëzimin e dokumentacionit, që ekspozon njësinë drejt risqeve, në mënyrë të vazhdueshme për përkthyesit e kontraktuar.					<b>1.2</b> Nga Ministria e Drejtësisë, në bashkëpunim me organet përkatëse, të merren masat e nevojshme hartimin e një baze rregullative mbi përkthimin e dokumentacioneve të klasifikuara, me qëllim eliminimin e risqeve të mundshëm gjatë kësaj veprimtarie.	Drejtorja për Marrëdhëniet Juridiksionale dhe Bashkëpunimin Ndërgjyqësor

2	<p>Janë konstatuar pagesa të padrejta nga buxheti i shtetit, për kostot e mirëmbajtjes së katër sistemeve, në shumën <b>5,862,400 lekë</b>, kosto të cilat duhet të përballohen nga AKSHI, tek I cili duhet të ishin transferuar sistemet sipas vkm-së nr.673, dt 22.11.2017 "Për Organizimin e AKSH-it" e ndryshuar, si dhe nuk janë kryer veprimet në regjistrin e aktiveve për raktivet e transferuara tek AKSHI.</p>	<p><b>2.1</b> Institucioni të marri masat e nevojshme, për hostimin e sistemeve IT pranë AKSHI-t referuar përcaktimeve të VKM nr.673 datë 22.11.2017, e ndryshuar, duke dokumentuar plotësisht transferimin e tyre fizik dhe kontabël si dhe eliminimin e kostove të panevojshme nga buxheti i institucionit për shërbimet e mirëmbajtjes së tyre.</p>	<p>Drejtoria për Marrëdhëniet Juridiksionale dhe Bashkëpunimin Ndërgjyqësor&amp; Drejtoria e Derregullimit, lejeve Licensave dhe Monitorimit</p>	<p>E lartë</p>	<p>Menjëherë</p>	<p>Në lidhje me këtë rekomandim, Ministria e Drejtësisë do të ndërmarrë inisiativë për ndryshimin e VKM-së nr.673 datë 22.11.2017 me qëllim që sistemet elektronike në fjalë të mos kalojnë në administrim të AKSHI-t për shkak të informacionit sensitive që përmbajnë.</p>
3	<p>Në procedurën e shpenzimeve, blerjet nëpërmjet sistemit dinamik të biletave të transportit ajror ndërkombëtar për vitin 2019, zënë 33% e shpenzimeve, ku dokumentacioni shoqërues nuk argumenton, numrin e pjesëmarrësve në takime apo evente dhe procedura e blerjes së biletave realizohet në një kohë të shkurtër, pa pasur mundësi për studimin e tregut.</p>	<p><b>3.1</b> Nga Titullari i Institucionit, të merren masa që pas ardhjes së ftesës nga organizatorët për takime/evente jashtë vendit, të nxirret menjëherë autorizimi i pjesëmarrjes në to, në mënyrë që të minimizohet risku i blerjes së biletave me çmim më të lartë si rezultat i kryerjes së procedurës së prokurimit në data të afërta me datën e nisjes së udhëtimit.</p>	<p>Titullari</p>	<p>E lartë</p>	<p>Në vijimësi</p>	<p>Megjithëse vizitat zyrtare dhe të punës të anëtarëve të Këshillit të Ministrave jashtë shtetit, kërkojmë paraprakisht miratimin nga KM dhe MEPJ, Ministria e Drejtësisë do të marrë masat e nevojshme (për aq sa do të jetë e mundur) për nxjerrjen e autorizimit në një kohë sa më të shkurtër të mundshme.</p>
	<p>Moskufizimi i numrit të pjesëmarrësve në takime apo evente, ka sjellë rritje të përdorimit të fondeve buxhetore, për periudhën Janar-Tetor 2019.</p>	<p><b>3.2</b> Të argumentohet numri i pjesëmarrësve në takime/evente të organizuara jashtë vendit në mënyrë që të optimizohet numri i tyre dhe për rrjedhojë dhe shpenzimet që kryen për këtë qëllim.</p>	<p>Titullari</p>		<p>Në vijimësi</p>	<p>Lidhur me këtë rekomandim, Ministria e Drejtësisë, megjithëse nuk ka rritje të nivelit të shpenzimeve për shërbime jashtë vendit, krahasuar me vitet paraardhëse, do të marrë masat për të parë mundësinë e reduktimit (për aq sa do të jetë e mundur) të numrit të pjesëmarrësve në shërbimet jashtë vendit.</p>

Shënim: Gjetjet janë pasqyruar në mënyrë të përmblodhur.